

IMAM ALBANI

إمام الألباني

Sunetet e neglizhuara në
RAMAZAN

السنن المهجورة

في رمضان



Selef.org
Kurani dhe Suneti sipas kuptimit të Selefëve të këtij Umeti

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Allahu, i Madhëruar dhe i Lartësuar, në Kuranin Fisnik thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الصِّيَامُ كَمَا كُتِبَ عَلَى الَّذِينَ مِن قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ

“O ju që keni besuar! Ju është bërë obligim agjërimi, ashtu si u ishte obliguar atyre para jush, që të mund të bëheni të devotshëm.”¹

Në këtë ajet – ashtu siç e kuptojnë të gjithë ata që janë të pranishëm – Allahu, i Plotfuqishëm dhe i Madhëruar, e njofton Umetin e Muhamedit, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij, për atë që ia ka zbritur Pejgamberit të Tij, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, në këtë ajet, se Allahu ua ka obliguar atyre agjërimin ashtu siç ua bëri obligim popujve që ishin para nesh.

Kjo është një gjë e njohur tek të gjithë Muslimanët që e lexojnë këtë ajet fisnik dhe e kuptojnë qartë domethënien e tij. Porse gjëja për të cilën unë dua të flas, është diçka tjetër. Pak i kushtohet vëmendje apo të pakët janë njerëzit e thjeshtë që i kushtojnë vëmendje kësaj, e ajo është Fjala e Tij, të Madhëruarit dhe të Lartësuarit, në fund të këtij ajeti:

لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ

“Që të mund të bëheni të devotshëm.”²

Pra, Allahu, i Plotfuqishëm dhe i Madhëruar, zakonisht me robërit e Tij besimtarë kur ai i urdhëron për ndonjë gjë apo ua ligjëson një obligim, Ai, i Madhëruari dhe i Lartësuari, kufizohet tek përmendja e urdhrit pa mos e sqaruar urtësinë e tij.

Ngaqë, urtësia e përgjithshme në ngarkimin e obligimeve nga ana e Allahut, të Plotfuqishmit dhe të Madhëruarit, ndaj robërve të Tij është që t'i sprovtojë ata përmes atij urdhri, dhe të dalë në shesh ai që i bindet Atij dhe ai që e kundërshton Atë.

Por, Ai në këtë ajet, ka përmendur një gjë të pazakonshme në Kuranin Fisnik, e që është arsyeja e urdhërimit të agjërimit, përmes Fjalës së Tij:

¹ El-Bekare, 183.

² El-Bekare, 183.

لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ

“Që të mund të bëheni të devotshëm.”³

Andaj, urtësia e obligimit të agjërimit për besimtarët nuk është vetëm që të përmbahen nga kënaqësitë dhe të lejuarat, e që janë gjërat e mira, edhe në qoftë se ky është një urdhër që është obligim për çdo agjërues, porse nuk është vetëm ky qëllimi me këtë agjërim, të cilin Allahu, i Plotfuqishëm dhe i Madhëruar, e ka përfunduar urdhrin e Tij me Fjalën e Tij, të Lavdëruarit dhe të Lartësuarit:

لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ

“Që të mund të bëheni të devotshëm.”⁴

Nga urtësia e ligjësisimit të agjërimit është që Muslimani në muajin e agjërimit ta shtojë bindjen (nënshtrimin) ndaj Allahut, të Madhëruar e të Lartësuar, më shumë se para Ramazanit.

Pejgamberi, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij, e ka sqaruar dhe shtjelluar këtë urtësi që vjen prej Zotit me fjalën e tij, siç qëndron në Sahihun e Bukharit se ai, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë:

مَنْ لَمْ يَدَعْ قَوْلَ الزُّوْرِ وَالْعَمَلَ بِهِ فَلَيْسَ لِلَّهِ حَاجَةٌ فِي أَنْ يَدَعَ طَعَامَهُ وَشَرَابَهُ

“Ai që nuk i lë fjalët e këqija (çdo fjalë haram) dhe punën me të (çdo punë haram), Allahu nuk ka nevojë që ai ta lë ushqimin dhe pijen e tij.”

Që do të thotë se Allahu nuk ka për qëllim me obligimin e agjërimit frenimin (nga ushqimi) për një kohë të caktuar, që njihet tek të gjithë, e që është largimi i agjëruesit nga ngrënia dhe pirja dhe të mjaftohen me kaq.

³ El-Bekare, 183.

⁴ El-Bekare, 183.

Por, duhet gjithashtu, që të largohen nga ajo që Allahu, i Plotfuqishëm dhe i Madhëruar, e ka bërë haram, e që janë mëkatet, mosbindja dhe prej tyre janë fjalët e këqija dhe punët e këqija.

Kështu që, i Dërguari, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij, e thekson ajetin:

لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ

“Që të mund të bëheni të devotshëm.”⁵

Që do të thotë: të kërkon afim tek Allahu, i Plotfuqishmi dhe i Madhëruari, duke ia shtuar kësaj largimin tuaj nga ushqimi dhe pirja. Po ashtu, që të largoheni nga haramet, siç janë: përgojimi, mbarja e fjalëve, fjalët e këqija, dëshmia e rrejshme, gënjeshtër si dhe gjëra të ngjashme nga sjelljet e ndaluara, siç e dimë të gjithë. Për hir të kësaj, të gjithë Muslimanët e kanë për detyrë që ta dinë se gjërat që ia prishin Ramazanin agjëruesit, nuk janë vetëm gjërat materiale që njihen në përgjithësi si: ushqimi, pirja dhe marrëdhëniet intime, nuk është agjërimi vetëm ky.

Për këtë arsye, disa dijetarë bëjnë dallim dhe i ndajnë gjërat që e prishin agjërimin në dy kategori. E ky është synimi im nga ky fjalim në këtë kohë të bekuar – in sha Allah – posaçërisht meqë është bërë zakon tek ata që mbajnë hutbe dhe japin këshilla në muajin e Ramazanit që, kur flasin rreth gjërave që e prishin agjërimin e agjëruesit, flasin vetëm për gjërat materiale që e prishin agjërimin nga ajo që e përmendëm pak më parë, e që është: ushqimi, pirja dhe marrëdhëniet intime. Por, ata si këshillues dhe përkujtues ndaj Muslimanëve në përgjithësi, duhet që të flasin më shumë rreth kategorisë së dytë të gjërave që e prishin agjërimin, sepse njerëzit e kanë bërë zakon që të kuptojnë se agjërimi është nga lloji i parë: largimi nga gjërat materiale që e prishin agjërimin. Por ekzistojnë gjëra të tjera që e prishin agjërimin dhe ato gjëra mund t'i quajmë abstrakte.

E dëgjuat pak më parë fjalën e tij, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të:

مَنْ لَمْ يَدَعْ قَوْلَ الزُّورِ وَالْعَمَلَ بِهِ فَلَيْسَ لِلَّهِ حَاجَةٌ فِي أَنْ يَدَعَ طَعَامَهُ وَشَرَابَهُ

⁵ El-Bekare, 183.

“Ai që nuk i lë fjalët e këqija (çdo fjalë haram) dhe punën me të (çdo punë haram), Allahu nuk ka nevojë që ai ta lë ushqimin dhe pijen e tij.”

Për këtë arsye, çdo agjërues duhet që të ketë kujdes ndaj vetes së tij se a agjëron duke u përmbajtur vetëm nga gjërat materiale apo agjëron duke u përmbajtur nga gjërat abstrakte, që do të thotë se a e ka përmirësuar moralin dhe sjelljen e tij kur ka hyrë Ramazani i bekuar, nëse është i tillë, atëherë ai e ka realizuar Fjalën e Tij, të Madhëruar dhe të Lartësuarit, në fund të ajetit:

لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ

“Që të mund të bëheni të devotshëm.”⁶

Por, ai që e kufizon agjërimin e tij në largimin nga ngrënia dhe pirja, ai është neglizhent dhe vazhdon me moralin e tij të keq të cilin e kishte para Ramazanit.

Kështu që, ky nuk është agjërimi i cili kihet për qëllim nga urtësia e Sheriatit të këtij muaji të bekuar, për të cilin ka treguar Zoti jonë, i Plotfuqishëm dhe i Lavdëruar, në Fjalën e Tij:

لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ

“Që të mund të bëheni të devotshëm.”⁷

Andaj, ne këshillojmë dhe i përkujtojmë vëllezërit tanë Muslimanë që të meditojnë për këtë prishësin tjetër abstrakt, për të cilin shumë pak flasin ata që mbajnë këshilla dhe ata që japin udhëzime, e lëre të mos flasim që ta përkujtojnë këtë dhe të kenë kujdes njerëzit e thjeshtë Muslimanë ndaj këtij lloji të prishësit, e ai është prishësi abstrakt (i agjërimin).

⁶ El-Bekare, 183.

⁷ El-Bekare, 183.

Me këtë desha t'i përkujtoj vëllezërit tanë të pranishëm në këtë ndenjje (mexhlis) të mirë – in sha Allah – në mënyrë që kjo të jetë shkak për shtimin e afrimit të tyre te Allahu, i Madhëruar dhe i Lartësuar, në këtë muaj të bekuar, muajin e agjërimit. Në të cilin shpresojmë nga Allahu, i Madhëruar dhe i Lartësuar, të na japë sukses të gjithëve në përmbushjen e detyrës së këtij muaji të bekuar, duke u përmbajtur nga gjërat që e prishin agjërimin, e që janë materiale dhe abstrakte.

Pastaj, për të shtuar në këtë fjalim, shpresoj që t'ia vini veshin asaj që do t'ju thuhet rreth një gjëje, ndaj të cilës shumica e Muslimanëve janë të shkujdesur për të, madje edhe nga ata që janë të dalluar.

Ka një hadith që shpeshherë lihet pas dore për shkak të një hadithi tjetër që shumica e njerëzve nuk mund të bëjnë bashkim në mes tyre, në zbatimin dhe të punuarit me të. E ai hadith është fjala e tij, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të:

لاتَزَالُ أُمَّتِي بِخَيْرٍ مَا عَجَّلُوا الْفِطْرَ وَأَخَّرُوا السَّحْرَ

“Ummeti im do të vazhdojë në mirësi përderisa e shpejtojnë iftarin dhe e vonojnë syfyrit.”

Këtu kemi dy gjëra që janë neglizhuar nga shumë njerëz, ato janë: përshpejtimi i iftarit dhe vonimi i syfyrit. Sa i përket neglizhimit të çështjes së parë, e që është përshpejtimi i iftarit, kjo çështje – sipas mendimit të disave – kundërshton hadithin tjetër, e ajo është fjala e tij, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij:

لاتَزَالُ أُمَّتِي بِخَيْرٍ مَا عَجَّلُوا مَا بِصَلَاةِ الْمَغْرَبِ

“Ummeti im do të vazhdojë në mirësi përderisa e shpejtojnë namazin e akshamit.”

Andaj, këtu kemi dy urdhra që kërkojnë të përshpejtohen dy gjëra. Kështu që, disave iu duket se nuk mund të përshpejtohen dy gjëra në të njëjtën kohë. Çështja është në mes bashkimit (lidhjes) midis përshpejtimit të iftarit dhe përshpejtimit të namazit të akshamit.

Urdhërimi për bashkimin në mes shpejtimit të iftarit dhe shpejtimit të namazit të akshamit është çështje tepër e lehtë, e cila është nga ajo që Pejgamberi jonë, lëvdatat dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, na e ka bërë të qartë me vepra dhe punë, ku ai, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, bënte iftar me tre hurma, pastaj e falte

akshamin. Pastaj, kthehej dhe hante darkë nëse kishte nevojë për darkë. Ne sot, biem në dy kundërshtime:

E para: E vonojmë ezanin nga koha e tij e ligjësuar, dhe pas kësaj vonese, vjen vonesa tjetër, e ajo është se neve ulemi për të ngrënë, përveç një pakice njerëzish të cilët janë të përpiktë dhe e falin akshamin në xhami. Por njerëzit në përgjithësi, janë ata të cilët, së pari, vonohen derisa ta dëgjojnë ezanin, kur e dëgjojnë ezanin ulen për të ngrënë sikur hanë drekë apo darkë, dhe nuk ulen sa për të prishur agjërimin (pra, të hanë pak dhe të shpejtojnë në faljen e namazit me xhemat në xhami, sh.p.).

Ezani në këtë kohë, në shumë vende Islame – e them këtë me keqardhje dhe kjo nuk ndodh vetëm në Jordani, këtë e di në bazë të hulumtimit që kam bërë për shumë vende Islame – thirret ezani i akshamit pas kohës së tij dhe shkak për këtë është se neve e kemi braktisur kapjen pas dispozitave Sheriatike dhe zbatimin e tyre në vepra dhe i jemi mbështetur llogaritjeve kalendarike. Jemi kapur pas asaj që quhet sot “kalendar”, apo “takvim”.

Këto kalendarë bazohen në llogaritje astronomike të cilat e llogarisin token si të sheshtë, dhe jep një llogaritje për këtë vend (tokë) të sheshtë, kurse toka – sidomos në vendin tonë – dallon midis ultësirës në një luginë dhe një toke të ngritur, një mali. Andaj, nuk është e saktë që kalendari të jetë një i vetëm e t’i përfshijë brigjet, fushat, malet. Jo! Çdo vend e ka kohën e tij të caktuar.

Andaj, ai që ka mundësi – e që është në qytetin e tij të banimit apo në fshatin e tij – ta shohë diellin me sy kur ai perëndon, atëherë ky është shpejtimi i iftarit për të cilin jemi urdhëruar me fjalën e tij, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të:

لا تَزَالُ أُمَّتِي بِخَيْرٍ مَا عَجَّلُوا الْفَطْرَ

“Ummeti im do të vazhdojë në mirësi përderisa e shpejtojnë iftarin”.

Pejgamberi, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij, kujdesej për zbatimin e këtij sunneti duke ua mësuar atë të tjerëve dhe duke e zbatuar vetë. Ai, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë në një hadith tjetër të cilin e ka nxjerrë Buhariu në Sahihun e tij:

“Kur dita të lind nga kjo anë – dhe bëri me shenjë nga Lindja – dhe të mbarojë nga kjo anë – dhe bëri me shenjë nga Perëndimi – dhe të perëndoje dielli, atëherë agjëruesi bën iftar.”

Ç’do të thotë se agjëruesi bën iftar? Do të thotë, se ka hyrë në gjykimin e iftarit. Dhe në këtë çast vjen gjykimi paraprak, për të cilin i Dërguari, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, ka nxitur për shpejtimin e iftarit. I Dërguari, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, e zbatonte këtë edhe kur ishte në udhëtim.

Po ashtu, ka ardhur një transmetim në Sahihun e Buhariut se Pejgamberi, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij, urdhëroi njërin nga Sahabët që ta sillte iftarin, dhe ai (Sahabiju) tha: **“O i Dërguari i Allahut! Është akoma ditë”**, kishte për qëllim dritën e diellit, edhe në qoftë se dielli ka perënduar porse drita e tij dukej akoma nga ana e Perëndimit. I Dërguari, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, nuk iu përgjigj, porse ia ritheksoi këtë çështje duke i thënë që ta sillte iftarin.

Transmetuesi i hadithit thotë: **“E shikonim se akoma ishte ditë”**, pra drita e ditës, drita e diellit, **“kur ne bëmë iftar, sikur ndonjëri nga ne t’i hipte devesë, do ta shikonte diellin.”**

Dielli perëndoi nga kjo anë dhe i Dërguari, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, urdhëroi njërin nga Sahabët që ta sillte iftarin. Përse? Të shpejtonte për shkak të mirësisë.

لاتزال أمتي بخير ما عجلوا الفطر

“Ummeti im do të vazhdojë në mirësi përderisa e shpejtojnë iftarin”.

E rëndësishme është që neve vërejmë se për shpejtimin e iftarit sipas Sheriatit, duhet të fillohet me hurma, pastaj nxitimi për të falur namazin, dhe pas kësaj, njerëzit ulen dhe hanë aq sa kanë nevojë. Kjo ishte çështja e parë me të cilën desha t’ju përkujtoj, e ajo është bashkimi midis dy urdhrave për të cilat Pejgamberi, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, urdhëroi që të shpejtohet me to.

E para: shpejtimi i iftarit.

E dyta: shpejtimi për në namazin e akshamit (me xhemat).

Iftari çelet me hurma siç është sunneti. Dhe në qoftë se nuk i lehtësohet kjo, atëherë me disa gllënjka ujë, pastaj fal namazin me xhemat në xhami.

Çështja tjetër me të cilën dua t’ju përkujtoj është ajo që ka ardhur në hadithin paraprak, **“Vonojnë syfyryn”**, d.m.th. po ashtu kërkohet që të bëhet e kundërta e

iftarit. Pra, na ka urdhëruar që ta shpejtojmë atë, kurse për syfyrin duhet që ai të vonohet. Ndërsa realiteti i sotshëm është plotësisht e kundërta, ku shumica e njerëzve hanë syfyr para daljes së agimit, ndoshta një orë përpara. Kjo nuk është në rregull. Kjo bie ndesh në sunnetin në fjalë dhe në sunnetin në vepra.

Sahabët e Pejgamberit, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, e vononin syfyrin saqë ndonjëri prej tyre gati sa nuk e dëgjonte ezanin, kurse ai ishte duke ngrënë, e vononte syfyrin. Madje ka ardhur një hadith i vërtetë nga Pejgamberi, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij, ku tregohet qartazi për lehtësimin e Islamit, i cili lehtësim konsiderohet nga parimet e Islamit me të cilin Muslimanët mburren. Sidomos ajo që ka të bëjë me agjërimin, ku Allahu, i Plotfuqishëm dhe i Lavdëruar, i përfundoi ajetet të cilat i solli për veçantinë e agjërit, Allahu, i Plotfuqishëm dhe i Lavdëruar, i përfundoi ajetet me Fjalën e Tij:

يُرِيدُ اللَّهُ بِكُمُ الْيُسْرَ وَلَا يُرِيدُ بِكُمُ الْعُسْرَ

“Allahu dëshiron që t’jua lehtësojë dhe jo t’jua vështirësojë.”⁸

Nga lehtësimi është fjala e tij, lëvdata dhe shpëtimi qoftë mbi të:

إِذَا سَمِعَ أَحَدُكُمُ النِّدَاءَ وَالْإِنَاءَ عَلَى يَدِهِ فَلَا يَضَعُهُ حَتَّى يَقْضِيَ حَاجَتَهُ مِنْهُ

“Nëse ndonjëri nga ju dëgjon ezanin ndërkohë që pjatën e tij e ka në dorë, le të mos e lëshojë atë derisa ta plotësojë nevojën e tij.”

Nëse ndonjëri nga ju dëgjon ezanin dhe pjata – pjata me ushqim, qoftë ai qumësht, pije, ujë, çfarëdo qoftë ajo që ai han syfyrin – e dëgjon ezanin, të mos thotë: tani ndalohet ngrënia e ushqimit. Jo! I ndalohet ushqimi me thirrjen e ezanit atij që e ka plotësuar nevojën e tij (është ngopur), kështu që këtij, nuk i lejohet që të vazhdojë të pijë apo të hajë ndonjë frutë, kur ai ka ngrënë nga të gjitha atë që ka dashur. Por, nëse e dëgjon ezanin dhe ai ende nuk ka përfunduar që ta plotësojë nevojën e tij nga ushqimi apo pija e tij, atëherë i Dërguari, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij, ia lejon këtë atij dhe thotë qartazi dhe me një gjuhë të kulluar Arabe:

⁸ El-Bekare, 185.

إِذَا سَمِعَ أَحَدُكُمْ النَّدَاءَ وَالْإِنَاءَ عَلَى يَدِهِ فَلَا يَضَعُهُ حَتَّى يَقْضِيَ حَاجَتَهُ مِنْهُ

“Nëse ndonjëri nga ju dëgjon ezanin ndërkohë që pjatën e ka në dorë, le të mos e lë atë derisa ta plotësojë nevojën e tij.”

Qëllimi këtu është për ezanin e dytë, dhe nuk është për ezanin e parë të cilin gabimisht e quajmë ezani i imsakut (ndalimit nga ngrënia dhe pirja). Këtë është detyrë që ta dimë, që nuk ka bazë që ta quajmë ezanin e parë ezan të imsakut, ezani i dytë është ezani i imsakut, dhe kjo është shkoqitur në Kuran, ngase Allahut, i Plotfuqishëm dhe i Lavdëruar, thotë:

وَكُلُوا وَاشْرَبُوا حَتَّى يَتَبَيَّنَ لَكُمُ الْخَيْطُ الْأَبْيَضُ مِنَ الْخَيْطِ الْأَسْوَدِ مِنَ الْفَجْرِ^ط

“Dhe hani e pini derisa ta dalloni fijen e bardhë (bardhësinë) e agimit nga fija e zezë (errësirën e natës).”⁹

Andaj, ushqimi ndalohet atëherë kur hyn koha e namazit të sabahut dhe lejohet falja e tij. Nuk ka ndonjë shkëputje midis këtyre dyjave (imsakut dhe hyrjes së kohës së namazit të sabahut), nuk ka imsak një çerek ore apo më shumë apo më pak midis hyrjes së kohës së namazit të sabahut dhe kohës së ndalimit të ushqimit. Kurrresi. Ngase namazi është obligim (që të falet) me daljen e agimit të vërtetë dhe agjëruesit i ndalohet (ushqimi) me daljen e agimit të vërtetë. Andaj, nuk ka midis këtyre dyjave ndonjë ndarje absolutisht.

Prandaj, ka ardhur një hadith që janë pajtuar për të Buhariu dhe Muslimi nga hadithi i Abdullah ibën ‘Umer bin Khattab, Allahu qoftë i kënaqur me të dy, se Pejgamberi, lëvduta dhe shpëtimi i Allahut qoftë për të dhe familjen e tij, ka thënë:

“Të mos ju mashtrojë ezani i Bilalit – pra, ezani i parë – sepse ai thërret që të zgjohet ai që është në gjumë dhe të hajë syfyr agjëruesi, andaj hani dhe pini derisa ta thërrasë ezanin Ibën Umm Mektum.”

⁹ El-Bekare, 187.

Ibën Umm Mektum quhej Umer i cili ishte i verbër dhe për të cilin zbriti Fjala e Tij, të Madhëruarit dhe të Lartësuarit:

عَبَسَ وَتَوَلَّى ۖ أَنْ جَاءَهُ الْأَعْمَىٰ

“Ai u vrenjt dhe e ktheu kurrizin, kur i erdhi pranë i verbëri.”¹⁰

E deri në fund të ajeteve.

Ky e thërriste ezanin e dytë, ezani me të cilin ndalohej ngrënia e ushqimit dhe hynte koha e namazit të sabahut. Si e thërriste ezanin kur ai ishte i verbër? Kjo pyetje natyrisht ka mbërritur në veshët e disa njerëzve.

Umer ibën Umm Mektum, Allahu i Lartësuar qoftë i kënaqur me të, ai hipte sipër xhamisë, ai nuk e shihte agimin, porse priste ndonjë prej kalimtarëve të cilët kalonin pranë tij dhe nëse ata e shikonin se agimi kishte dalë dhe ishte përhapur në horizont, i thonin: “Gdhiu dita! Gdhiu dita!”, atëherë ai e thërriste ezanin.

Pra, ju këtu vëreni se ezani i Umer ibën Umm Mektumit ishte pas daljes së agimit dhe njerëzit e shikonin atë kur ecnin rrugëve. Në këtë kohë kur i thuhej atij se gdhiu dita, ai e thirrte ezanin.

Pra, tek kjo çështje ka hapësirë, ku muezini e vononte ezanin e tij derisa të dëgjonte njerëzit të thonë se gdhiu dita, gdhiu dita.

Pastaj i Dërguari, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij, ka thënë:

إِذَا سَمِعَ أَحَدُكُمْ النِّدَاءَ وَالْإِنَاءَ عَلَى يَدِهِ فَلَا يَضَعُهُ حَتَّىٰ يَفْضِيَ حَاجَتَهُ مِنْهُ

“Nëse ndonjëri nga ju dëgjon ezanin ndërkohë që pjatën e ka në dorë, le të mos e lë atë derisa ta plotësojë nevojën e tij.”

Allahu, i Plotfuqishëm dhe i Madhëruar, ka thënë në fund të atyre ajete që kanë të bëjnë me agjërimin:

¹⁰ ‘Abese, 1-2.

يُرِيدُ اللَّهُ بِكُمْ الْيُسْرَ وَلَا يُرِيدُ بِكُمْ الْعُسْرَ وَلِتُكْمِلُوا الْعِدَّةَ وَلِتُكَبِّرُوا اللَّهَ عَلَىٰ مَا هَدَاكُمْ وَلَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ ﴿١٨٥﴾

“Allahu dëshiron që t’jua lehtësojë dhe jo t’jua vështirësojë dhe që ju duhet të plotësoni numrin e ditëve dhe që ju duhet ta madhëroni Allahun duke bërë tekbir për shkak se ju ka udhëzuar dhe ju duhet të jeni falenderues.”¹¹

Nga kuptimi jo i drejtë dhe që bie ndesh me sunnetin është që të thotë dikush se agjëruesi nëse e dëgjon ezanin dhe ka një kafshatë në gojën e tij, e ka obligim që ta hedh atë.

Kjo është ekstremizëm dhe skajshmëri në fe.

Zoti i botëve na ka këshilluar dhe na ka përkujtuar në Librin e Tij dhe sunnetin e Pejgamberit të Tij, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij, që të mos e teprojmë në fenë tonë, andaj në Kuranin Fisnik ka thënë:

يَا أَهْلَ الْكِتَابِ لَا تَغْلُوا فِي دِينِكُمْ وَلَا تَقُولُوا عَلَى اللَّهِ إِلَّا الْحَقَّ

“O ithtarë të Librave (Jehudë dhe të Krishterë), mos e teproni në fenë tuaj dhe mos thoni për Allahun vetëm se të vërtetën.”¹²

I Dërguari jonë, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë:

“Ruhuni nga ekstremizmi në fe, sepse ata që ishin para jush i shkatërroi ekstremizmi (teprimi) në fe.”

Apo ai, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë:

“Ajo që i shkatërroi ata që ishin para jush ishte ekstremizmi (teprimi) në fenë e tyre.”

¹¹ El-Bekare, 185.

¹² En-Nisa, 171.

Përderisa i Dërguari i Allahut, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij, na ka sqaruar gjerësisht dhe qartazi çështjen e atij që ha syfyr, saqë ka thënë:

إِذَا سَمِعَ أَحَدُكُمْ النَّدَاءَ وَالْإِنَاءَ عَلَى يَدِهِ فَلَا يَضَعُهُ حَتَّى يَفْضِيَ حَاجَتَهُ مِنْهُ

“Nëse ndonjëri nga ju dëgjon ezanin ndërkohë që pjatën e ka në dorë, le të mos e lë atë derisa ta plotësojë nevojën e tij.”

Atëherë, kjo është kundërshtim ndaj Allahut dhe të Dërguarit, që personi t’i thotë atij që dëgjon ezanin dhe ka në gojë një kafshatë: “Nxirre apo gjuaje për toke.”

Kjo nuk është prej sunnetit, madje është në kundërshtim me sunnetin dhe është në kundërshtim me urdhrin e qartë e të Dërguarit, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij.

Jam pyetur shumë dhe nuk lë hapësirë për këshillë ndaj një pyetje të këtillë, po u them atë që e thashë pak më parë, se ky hadith gjendet në Gjashtë Librat më të njohur, prej tyre: Suneni i Ebu Daudit, dhe ky është libri i tretë nga Gjashtë Librat e njohur, i pari i tyre është Sahihu i Buhariut, i dyti është Sahihu i Muslimit, i treti Suneni i Ebu Daudit. Ky hadith gjendet këtu.

Po ashtu e ka transmetuar Abdullah el-Hakim në Mustedrekun e tij. Po ashtu e ka nxjerrë Imami, Imami i Sunnetit Ahmed bin Hanbel, Allahu e mëshiroftë, në librin e tij madhështor e të njohur si Musnedi i Imam Ahmedit. Atëherë, hadithi nuk është nga hadithet garib (i vetëm, i panjohur), përkundrazi është nga hadithet e njohura të cilin e kanë transmetuar imamët e vjetër të sunnetit me zinxhir të saktë.

Dhe këtu them duke e përmbyllur këtë fjalim, ndoshta ndonjëri nga ju ka ndonjë pyetje e ne do t’i përgjigjemi – in sha Allah – po e mbyll këtë fjalim me fjalën e tij, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të:

إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ أَنْ تُؤْتَى رُحْصُهُ كَمَا يُحِبُّ أَنْ تُؤْتَى عَزَائِمُهُ

“Allahu do që të merren lehtësimet e Tij ashtu siç do që të kryhen obligimet e Tij.”

Dhe në një transmetim tjetër thotë:

كما يكره أن تُؤتَى معصيته

“Ashtu siç e urren që t’i bëjnë gjynahe.”

Ka dy transmetime, e para:

“Vërtetë Allahu, i Plotfuqishëm dhe i Madhëruar, do që të merren lehtësimet e Tij ashtu siç do që të kryhen obligimet e Tij.”

Dhe transmetimi i dytë:

“Ashtu siç e urren që t’i bëjnë gjynahe.”

Andaj, Muslimanit nuk i ka hije që të shfaqë devotshmëri të rreme dhe të zmbrapset nga bindja ndaj Pejgamberit, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, për atë që na ka nxitur dhe na ka lehtësuar.

Me kaq po i japim fund, lavdërimi dhe falenderimi i takon Allahut, Zotit të botëve.

Pyetje-Përgjigje:

Njëri nga të pranishmit: Allahu të shpërbleftë më të mira.

Shejkh Albani: Edhe juve. Nëse ndonjëri ka ndonjë pyetje apo ndonjë apo paqartësi, shpresojnë që Allahu të na japë sukses t’i përgjigjemi, in sha Allah.

Pyetësi: Dy ezanet, a janë sunnet o Shejkh?

Shejkh Albani: Po! Mendoj se kjo pyetje ishte brenda hadithit të mëparshëm: “**Të mos ju mashtrojë ezani i Bilalit, sepse ai thërret që të zgjohet ai që është në gjumë dhe të hajë syfyri agjëruesi, andaj hani dhe pini derisa ta thërrasë ezanin Ibën Umm Mektum.**” Dhe ai nuk e thirrte ezanin derisa t’i thonin se gdhiu dita. Pra, ka dy ezane jo vetëm për Ramazan, madje edhe përgjatë ditëve të vitit.

Urtësia e ezanit të parë është shumë e qartë në po të njëjtin hadith: që të zgjohet ai që është në gjumë dhe që të hajë syfyr ai që do agjërojë. Ai që është në gjumë zgjohet gjatë gjithë ditëve të vitit që të falë namaz vullnetar (nafil) në fund të natës, të falet në fund të natës, zgjohet që të hajë syfyr për të agjëruar ditën e hënë, ditën e enjte, ditët e bardha (dita e trembëdhjetë, katërmëdhjetë dhe pesëmbëdhjetë e çdo muaji sipas kalendarit hënor). Ai agjëron dhe bën iftar siç është me sunnet. Kështu që, Muslimanët janë të nevojshëm për këtë ezan të parë përgjatë tërë ditëve të vitit dhe zakoni në disa vende është se ata nuk e thërrasin ezanin e parë vetëm se në Ramazan. Kjo në këtë kohë është ngushtim i këtij sunneti të gjerë e cili e përfshinë tërë vitin.

Andaj, muezinët duhet që të thërrasin në namazin e sabahut dy ezane gjatë gjithë vitit. Në mes ezanit të parë dhe të dytit ka përafërsisht njëzet minuta apo një çerek ore. Kështu ka ardhur ajo që tregohet në disa hadithe të sakta. Pra, ato janë dy ezane, jo vetëm për Ramazan, por gjatë gjithë vitit. Tjetri me radhë (që do të pyes).

Pyetësi: Shejkhu jonë, diçka që ka të bëjë me të njëjtën pyetje të vëllait tonë, Allahu e bekoftë, e ajo është tethuibi (shitesa) “essalatu khajru min en-neum – namazi është më mirë se gjumi”, e thonë atë në ezanin e dytë. Andaj duam ta dimë si është sunneti në mënyrë që të plotësohet dobia.

Shejkh Albani: Kjo është një pyetje e mirë. Në Sunenin e Nesaiut dhe në Sunenin e Ibën Khuzejmes si dhe te të tjerët në Gjashtë Librat, ka ardhur një hadith se Pejgamberi, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij, ia mësoi ezanin njërit prej Sahabëve, i cili njihet si Ebu Mahdhurah, e ai ezan është ai që njihet sot, porse me përsëritjet e disa pjesëve të ezanit duke i thënë më përpara apo më vonë. Ezani sheriatik fillon me tekbir (Allahu Ekber) dhe mbaron me tehlil (la ilahe il-Allah) në fund të ezanit.

Ai, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi, e mësoi kështu, por i tha:

Kur të thërrasësh ezanin e parë, pasi që të thuash “Hajj ‘ale salati hajj ‘ala salah” thuaj: “Esselatu khajru min en-neum, esselatu khajru min en-neum.”

Kjo në gjuhën e Sheriatit quhet tethuibi, d.m.th. fjala “Esselatu khajru min en-neum”, e ka vendin në ezanin e parë e jo në ezanin e dytë. Kjo është kështu ngaqë ezanin e parë e kuptuam nga hadithi paraprak se përse është ligjësuar? Që ta zgjojë atë që fle dhe të hajë syfyr ai që do agjërojë.

Pra, nëse vendoset ky tethuib në ezanin e dytë, i bie vlëra, ngaqë njerëzit në ezanin e dytë do jenë zgjuar e nuk do jenë në gjumë. Prandaj, sunneti në bazë të transmetimit dhe logjikës përputhet me ezanin e parë e jo me ezanin e dytë. Kështu që, ai që ka mundësi ta ringjallë këtë sunnet, do t'i shkruhet shpërblim për të dhe për shpërblimin e atyre që do punojnë me të deri në Ditën e Gjykimit duke mos i mbetur mangët asnjë nga shpërblimi i tyre – siç ka ardhur në hadithin e saktë.

Pyetësi: Më lejoni o Shejkh im për të njëjtën pyetje dhe të njëjtën temë...

Shejkh Albani: Urdhëro.

Pyetësi: Nëse muezini nuk zgjohet në ezanin e parë, a i lejohet që ta thotë tethuib-in në ezanin e dytë?

Shejkh Albani: Jo! Nuk i lejohet atij ngase i huton njerëzit se kinse koha (e syfyrit) akoma s'ka mbaruar. Në realitet, në ligjësimin e dy ezaneve ka urtësi të madhe. Po ashtu ka edhe një urtësi tjetër: Pejgamberi, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij, caktonte për çdo ezan nga një muezin.

Urtësia këtu është që dëgjuesit ta dallojë ezanin e parë nga ezani i dytë duke u bazuar në zërin e muezinit. Kjo është një dallim. Kjo gjithashtu është nga sunneti i cili duhet ringjallur. Ndërsa përgjigja për atë që më pyete: se patjetër suneti të mbetet në vendin e tij, pra vendi i fjalës “esselatü khajru min en-neum”, është në ezanin e parë.

Pyetësi: Jemi akoma në temën e ezanit, na lejo që të vazhdojmë, in sha Allah. Tani, një ezan i vetëm... në shumë xhami shtojnë në ezan. Çfarë gjykimi ka kjo?

Shejkh Albani: Për sa i përket shtesës në ezan, u fol pak më parë ku thamë: ezani i Pejgamberit fillon me “Allahu Ekber, Allahu Ekber” dhe mbaron me “La ilahe il-lAllah”. Më pëlqen një fjalë që thuhet në njërën nga vendet Arabe, e ajo është Siria, ku njerëzit e thjeshtë thonë: “Shtimi është vëllai i mangësisë.” Dhe kjo është e vërtetë. Kjo fjalë është marrë nga sunneti. Ai, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, thotë:

مَنْ أَحَدَّثَ فِي أَمْرِنَا هَذَا مَا لَيْسَ مِنْهُ فَهُوَ رَدٌّ

“Ai që shpik në çështjen (fenë) tonë atë që nuk është prej saj, nuk është prej nesh.”

Ju i dini hadithet, lavdia i takon Allahut, dhe ato janë të shumta në këtë kuptim. Pra, ashtu siç nuk i lejohet Muslimanit ta falë akshamin katër rekate, po ashtu nuk i lejohet ta falë akshamin me dy rekate. Përse? Sepse shtimi është vëllai i mangësisë. Ashtu si nuk lejohet të shtosh në fe, po ashtu nuk lejohet që të mangësosh prej saj. Ndoshta është e kundërta, që të jemi më të përpiktë në shprehje: ashtu siç nuk lejohet të mangësosh diçka prej fesë, po ashtu nuk lejohet të shtosh në të.

Ajo që të habit dhe që shumica njerëzve e kanë këtë gjë, është se që të gjithë janë të një mendje për qortimin e mangësimit të fesë, askush nuk mendon se lejohet që ta falësh akshamin dy regate ashtu siç e fal sabahun, por shumë njerëz mendojnë se lejohet të shtosh tek ajo që ka ardhur i Dërguari, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të. Siç janë adhurimet (ibadetet), veprat e mira.

Siç është rasti jonë tani në lidhje me ezanin. Ezani i të Dërguarit, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, të cilin ia mësoi Eba Mahdhuras – siç e përmendëm më lartë – dhe i njëjtë ishte edhe ezani i Bilal Habeshiut, të gjithë muezinët përgjatë kohërave dhe periudhave e fillonin ezanin me “Allahu Ekber, Allahu Ekber”, dhe e mbaronin me “La ilahe il-Allah”. Atëherë, kush është ai që e lejoi shtesën duke shtuar diçka në fillim apo në fund? Ata i përdorin mendjet e tyre. Ah sikur të ishin mendje që kanë kulturë të vërtetë Islame.

Ndonjëri nga ata thotë nëse i thuhet atij si për shembull: “O vëlla! Sunneti është që të ndalësh te fjala “La ilahe il-Allah”, dhe mos të shtosh përtej kësaj (në ezan).” Të thotë ty: “O vëlla! Ç’të keqe ka në të? Ç’të keqe ka në të?”.

Ai që e thotë këtë fjalë nuk ka menduar në njërën nga kuptimet e ajeteve apo haditheve të vërteta, ajetin fisnik që thotë:

الْيَوْمَ يَبْسُ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ دِينِكُمْ فَلَا تَخْشَوْهُمْ وَاخْشَوْنَ ۚ الْيَوْمَ أَكْمَلْتُ لَكُمْ دِينَكُمْ وَأَتَمَمْتُ عَلَيْكُمْ نِعْمَتِي وَرَضِيتُ لَكُمُ الْإِسْلَامَ دِينًا

“Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj.”¹³

¹³ El-Maideh, 3.

E plotësova... d.m.th. ka marrë fund pasi që është plotësuar, nuk ka mangësi në të. E si thotë ky Musliman: “Ç’ të keqe ka (të shtosh) në të – o vëlla – nëse unë shtoj dërgimin e salavateve për Pejgamberin, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, pas thirrjes së ezanit!”

O vëlla! Medito dhe reflekto. Ti po i atribuon tradhtinë Pejgamberit tënd, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, sikur ti të besojë (se lejohet të shtosh në fe) do të kishe dalë nga Islami, ngaqë Pejgamberit, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, i është folur me tekst të Kuranit dhe ai e zbatoi atë për të cilën u urdhërua me këtë tekst, e ajo është Fjala e Tij, të Plotfuqishmit dhe të Lavdëruarit:

﴿يَا أَيُّهَا الرُّسُولُ بَلِّغْ مَا أُنْزِلَ إِلَيْكَ مِنْ رَبِّكَ ۖ وَإِنْ لَّمْ تَفْعَلْ فَمَا بَلَغْتَ رِسَالَتَهُ ۗ وَاللَّهُ يَعْصِمُكَ مِنَ النَّاسِ ۚ إِنَّ اللَّهَ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الْكَافِرِينَ﴾

“O i Dërguar, përcille atë që të është shpallur nga Zoti yt. Në qoftë se nuk bën këtë, atëherë nuk e ke përcjellë Mesazhin e Tij; Allahu të ruan ty prej njerëzve. Pa dyshim se Allahu nuk i udhëzon njerëzit pabesimtarë.”¹⁴

Sa i “ëmbël” është hadithi i zonjës Aisheh, Allahu qoftë i kënaqur me të, ku ajo ka thënë në një hadith të saj, s’ka gjë që të përmendet plotësisht për shkak të dobisë që gjendet në të; ndoshta disa njerëz e kanë marrë të kundërtën që thuhet tekstualisht në këtë hadith.

Në Sahihun e Buhariut dhe Sahihun e Muslimit ka ardhur një hadith me zinxhir të saktë nga Mesruki i cili është nga të mëdhenjtë e Tabi’inëve, është një njeri me vlera, quhet Mesruk. Ky erdhi te zonja Aisheh, Allahu i Lartësuar qoftë i kënaqur me të, dhe i tha: “O nëna e besimtarëve! Muhamedi, a e ka parë Zotin e tij?” Ajo tha: “**M’u ngritën flokët (u rrëqetha) nga ajo që the.**” Ai tha: “O nëna e besimtarëve! Ki mëshirë për mua dhe mos u ngut me mua. A nuk thotë Allahu, i Madhëruar dhe i Lartësuar, në Kuranin Fisnik:

﴿وَلَقَدْ رَءَاهُ نَزْلَةً أُخْرَىٰ﴾

¹⁴ El-Maideh, 67.

“Ai e ka parë atë edhe në një zbritje tjetër (njëherë tjetër).”¹⁵

Ajo tha: **“Unë jam njeriu më i ditur për këtë. E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij, të thotë:**

“E kam parë Xhibrilin dy herë në formën e tij që është krijuar; kishte gjashtëqind krahë dhe e kishte mbuluar horizontin.”

Zonja Aisheh i shpjegon Mesrukit ajetin për të cilin e pyeti, e që mendonte se ajeti ka për qëllim se Muhamedi, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij, e ka parë Zotin e tij. Kështu që, ajo i tha: **“Unë jam njeriu më i ditur për këtë. E kam pyetur të Dërguarin e Allahut, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, për këtë ajet, e ai më tha:**

“E kam parë dy herë Xhibrilin në formën e tij që është krijuar; kishte gjashtëqind krahë dhe e kishte mbuluar horizontin.”

Pastaj, zonja Aisheh, Allahu i Lartësuar qoftë i kënaqur me të, e vazhdoi fjalën e saj e tha: **“Ai që të flet ty për tre gjëra, ai ka thënë shpifjen më të madhe për Allahun. (E Para): Ai që ju thotë se Muhamedi, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij, e ka parë Zotin e tij, ai e ka thënë për Allahun një shpifje të madhe.**

Lexojeni Fjalën e Tij, të Madhëruarit dhe të Lartësuarit:

﴿وَمَا كَانَ لِبَشَرٍ أَنْ يُكَلِّمَهُ اللَّهُ إِلَّا وَحْيًا أَوْ مِنْ وَرَآئِ حِجَابٍ﴾

“Asnjë njeriu nuk i është dhënë që t’i flasë Allahu, përveçse me anë të Shpalljes ose pas perdes.”¹⁶

Pra, kur i Dërguari i Allahut, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij, u ngrit në qiejt e lartë, nuk e pa Zotin e tij, sepse kur Allahu ia bëri obligim pesë namazet dhe i foli për këto namaze, i foli prapa perdes.

Dhe ky është kuptimi i ajetit të përmendur:

¹⁵ En-Nexhm, 13.

¹⁶ Esh-Shura, 51.

﴿ وَمَا كَانَ لِبَشَرٍ أَنْ يُكَلِّمَهُ اللَّهُ إِلَّا وَحْيًا أَوْ مِنْ وَرَآيِ حِجَابٍ ﴾

“Asnjë njeriu nuk i është dhënë që t’i flasë Allahu, përveçse me anë të Shpalljes.”¹⁷

D.m.th përmes Xhibrilit (që e sillte shpalljen).

أَوْ مِنْ وَرَآيِ حِجَابٍ أَوْ يُرْسِلَ رَسُولًا

“Ose prapa perdes ose të dërgojë ndonjë të Dërguar.”¹⁸

Pra, zonja Aisheh citoi se njerëzit nuk mund ta shohin Zotin e tyre në dunja: “Ai që ju thotë se Muhamedi, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij, e ka parë Zotin e tij, me të vërtetë ka thënë shpifje të madhe.”

Pastaj, lexoi ajetin:

﴿ وَمَا كَانَ لِبَشَرٍ أَنْ يُكَلِّمَهُ اللَّهُ إِلَّا وَحْيًا أَوْ مِنْ وَرَآيِ حِجَابٍ ﴾

“Asnjë njeriu nuk i është dhënë që t’i flasë Allahu, përveçse me anë të Shpalljes ose pas perdes.”¹⁹

Pastaj tha: “Ai që ju thotë se Muhamedi, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij, e dinte të fshehtë (gajbin), ai ka thënë shpifjen më të madhe për Allahun.”

Pastaj lexoi Fjalët e Tij, të Lartësuarit:

طَسَّ تِلْكَ آيَاتُ الْقُرْآنِ وَكِتَابٍ مُبِينٍ ﴿١﴾

“Thuaj: Askush, përveç Allahut, në qiell apo në tokë, nuk e di të fshehtë.”²⁰

¹⁷ Esh-Shura, 51.

¹⁸ Esh-Shura, 51.

¹⁹ Esh-Shura, 51.

²⁰ En-Naml, 65.

Pastaj tha – dhe këtu qëndron thelbi: “Kush thotë se Muhamedi, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij, ka fshehur diçka (prej fesë) për të cilën është urdhëruar që ta përcjellë – vini re, këtu është thelbi – ai që ju thotë se Muhamedi, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij, ka fshehur diçka (prej fesë) për të cilën është urdhëruar që ta përcjellë, ai ka thënë një shpifje të madhe për Allahun.”

Pastaj lexoi Fjalën e Tij, të Lartësuarit:

﴿يَا أَيُّهَا الرُّسُولُ بَلِّغْ مَا أُنْزِلَ إِلَيْكَ مِنْ رَبِّكَ ۚ وَإِنْ لَّمْ تَفْعَلْ فَمَا بَلَغْتَ رِسَالَتَهُ ۚ وَاللَّهُ يَعْصِمُكَ مِنَ النَّاسِ﴾

“O i Dërguar, përcille atë që të është shpallur nga Zoti yt. Në qoftë se nuk e bën këtë, atëherë nuk e ke përcjellë Mesazhin e Tij; Allahu të ruan ty prej njerëzve.”²¹

Pastaj tha: “Nëse Muhamedi do të fshehte diçka prej asaj që është urdhëruar tua përcjellë juve, do ta kishte fshehur Fjalën e Allahut, të Plotfuqishmit dhe të Madhëruarit:

وَإِذْ تَقُولُ لِلَّذِي أَنْعَمَ اللَّهُ عَلَيْهِ وَأَنْعَمْتَ عَلَيْهِ أَمْسِكْ عَلَيْكَ زَوْجَكَ وَاتَّقِ اللَّهَ وَتُخْفِي فِي نَفْسِكَ مَا اللَّهُ مُبْدِيهِ وَتَخْشَى النَّاسَ وَاللَّهُ أَحَقُّ أَنْ تَخْشَاهُ ۚ

“Dhe kur ti (o Muhamed) i the atij që Allahu e kishte begatuar dhe ti i bërë të mira: “Mbaje gruan tënde dhe frikësoju Allahut.” Ti po e fsheh në vetvete atë që Allahu do ta nxjerr në shesh dhe ti po u frikësohesh njerëzve, kurse më e drejtë është që t’i frikësohesh Allahut.”²²

²¹ El-Maideh, 67.

²² El-Ahzab, 37.

Nëse i Dërguari, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, do të fshehte diçka, do ta kishte fshehur këtë qortim nga Zoti i tij, porse kjo është zbatimin nga ana e tij ndaj ajetit të mëparshëm:

﴿يَا أَيُّهَا الرُّسُولُ بَلِّغْ مَا أُنْزِلَ إِلَيْكَ مِنْ رَبِّكَ ۖ وَإِنْ لَّمْ تَفْعَلْ فَمَا بَلَغْتَ رِسَالَتَهُ ۗ وَاللَّهُ يَعْصِمُكَ مِنَ النَّاسِ﴾

“O i Dërguar, përcille atë që të është shpallur nga Zoti yt. Në qoftë se nuk e bën këtë, atëherë nuk e ke përcjellë Mesazhin e Tij; Allahu të ruan ty prej njerëzve.”²³

Kështu që, i Dërguari, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, e përcolli Islamin me të gjitha anët e tij, nuk i la asnjë një shkronjë të vetme ndonjërit që ta kapë atë.

Përderisa i Dërguari i mësoi muezinët në kohën e tij se ezani fillon me “Allahu Ekber, Allahu Ekber” dhe mbaron me “La ilahe il-Allah”, atëherë është e saktë fjala e atyre që thonë “Shtimi është vëllai i mangësisë.”

Andaj, nuk lejohet aspak që të shtosh në fe, sepse feja është plotësuar. Sa e bukur është fjala e Abdullah bin Umer bin Khattab, Allahu qoftë i kënaqur me të dy, kur tha duke e shpjeguar hadithin e njohur “Çdo bidat është devijim” kështu është hadithi “Çdo bidat është devijim dhe çdo devijim është në zjarr”, kurse (Abdullah) Ibën Umer shtoi një fjalë të bukur që mund ta konsiderojmë si fjalë shpjeguese, ai tha:

كُلُّ بِدْعَةٍ ضَلَالَةٌ وَإِنْ رَأَاهَا النَّاسُ حَسَنًا

“Çdo bidat është devijim edhe në qoftë se njerëzit e shikojnë si të mirë.”

Dhe ky është realiteti i sotshëm, siç thamë që parë. Nëse thua: “Mos e bëj këtë.” Ai të thotë: “Ç’të keqe ka në të?!” O vëlla! Ka të keqe! Sepse ti po e korrigjon Pejgamberin tënd, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, a nuk të mjafton kjo?! Mjafton kjo dhe një pjesë e kësaj, mjafton si devijim dhe largim nga sunneti.

²³ El-Maideh, 67.

E lusim Allahun, e Plotfuqishëm dhe të Madhëruar, që të na bëjë të jetojmë me sunnet dhe të na e marrë shpirtin të gjithën neve në të, nëse do Allahu i Madhëruar dhe i Lartësuar.

Pyetësi: Ekziston një grup njerëzish nga Muslimanët që agjërojnë, të cilët bëjnë iftar para ezanit dhe ka një grup tjetër që bëjnë iftar në kohën e ezanit. Cili është gjykimi për këto dy grupe?

Shejkh Albani: Me aq sa duket, ti nuk paske qenë me neve, Allahu të bekoftë.

Pyetësi: Unë jam gjithmonë me ty o Shejkh, porse ti fole për ezanin e syfyrit.

Shejkh Albani: Edhe për ezanin e akshamit. Folëm edhe për ezanin e akshamit dhe folëm për shpejtimin e iftarit në aksham dhe për shpejtimin në faljen e namazit dhe e transmetuam fjalën e tij, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të:

“Do të vazhdojë ummeti im në mirësi përderisa e shpejtojnë iftarin.”

Dhe përmendëm se i Dërguari kur ishte në udhëtim i tha njërit nga sahabët: **“Na sill ushqimin e iftarit.”** Ai tha: **“Akoma është ditë.”** Ai i tha: **“Sille”.**

Dhe ky sahabiu tha se: **“sikur ndonjëri nga ne t’i hipte devesë së tij, do ta shikonte diellin.”**

Që do të thotë se iftari është menjëherë pas perëndimit të diellit. Po ashtu, përmenda një hadith që është obligim ta mësojmë ashtu siç e mësojmë el-Fatihanë, e ai është fjala e tij, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të:

إِذَا أَقْبَلَ اللَّيْلُ مِنْ هَا هُنَا، وَأَدْبَرَ النَّهَارُ مِنْ هَا هُنَا، وَغَرَبَتِ الشَّمْسُ، فَقَدْ أَفْطَرَ الصَّائِمُ

“Nëse nata bie nga kjo anë dhe dita largohet nga kjo anë (ana tjetër) dhe perëndon dielli, atëherë agjëruesi çel iftar.”

Është për obligim që të bëhet iftar menjëherë, s’ka më pritje.

Pyetësi: Një person është me një grup njerëzish dhe i gjithë grupi refuzon që të çelë iftarin, a i takon këtij personi që të çelë iftarin? Si e merr vesh ai që ka rënë nata dhe ka dalë dita?

Shejkh Albani: Allahu të bekoftë. Kemi përmendur më përpara fjalën e tij, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të:

“Kush ringjall në Islam një sunnet të mirë (të Pejgamberit).”

Ky person i cili e din se ka hyrë koha, pra ka hyrë koha e iftarit dhe shtoja kësaj edhe atë se ky e din se është sunnet shpejtimi i iftarit. Pra, nëse ai e merr gotën dhe pi, e merr hurmën dhe e ha atë përpara atyre njerëzve, ky a ka ringjallë një sunnet të mirë apo të keq?

Pyetësi: Të mirë, natyrisht.

Shejkh Albani: Po. Allahu të bekoftë.

Pyetësi: Ata do të thonë se ne kemi ringjall një sunnet të mirë, e presim ezanin që të thërrasë. Pra, sunneti jonë është i mirë...

Shejkh Albani: Këtu po hapim një kërkim tjetër shkencor, Allahu të bekoftë. Nëse ezani që ata e presin thërret në kohë, atëherë nuk i lejohet ndonjërit që të hajë para ezanit. Por, ne po flasim për ezanin në kohën tonë – mendoj se i ke dëgjuar këto fjalë – në këtë kohë thirret ezani 10 minuta pas perëndimit të diellit.

Pyetësi: Personi po flet për ezanin e kësaj kohe, nuk kemi për qëllim ezanin e parë.

Shejkh Albani: Atëherë, ajo që ai pret ezanin, nuk është sunnet, porse ai e ka kundërshtuar sunnetin.

Pyetësi: Agimi i vërtetë... kur ai thërret ezanin, agimi nuk ka dalë. Unë e shikoj agimin bashkë me ndjekjen e ezanit, në tokë akoma është natë, a më lejohet që të ha kur e di se akoma nuk ka dalë agimi?

Shejkh Albani: Ha. Kjo është sunnet, Allahu të bekoftë.

Pyetësi: Unë ha dhe ndërkohë që akoma s'ka dalë agimi...

Shejkh Albani: Po! Natyrisht, ky është sunneti, Allahu të bekoftë. Porse ne duam që njerëzit ta vëzhgojnë daljen e agimit.

Përktheu: Jeton Shasivari

1Ramadan1436 H

17 Qershor 2015